



Punësim dhe punë në Sllloveni

Employment Service
of Slovenia

Mbi 4000 vende të lira pune çdo ditë

Në faqen e internetit të Entit të Punësimit të Republikës së Sllovenisë, çdo ditë publikohen mbi 4000 vende të lira pune.

Shfletoni ato!

Më shumë se 1,200 EUR në muaj

Paga mesatare në Sllloveni për muajin qershor 2024 ishte:

- 2,366.79 euro bruto ose
- 1,501.97 euro neto.

Paga minimale për 2024 është:

- 1,253.90 euro bruto ose
- 902 euro neto për punë me kohë të plotë.

Ndihmë për fillimin

Republika e Sllovenisë ofron program për integrim në shoqërinë sllovene.

Informata të dobishme!

Vende te lira pune

Vendet e lira shpallen publikisht në Sllloveni. Punëdhënësit mund ta bëjnë këtë përmes Entit të Punësimit të Republikës së Sllovenisë, përmes mediave, në faqet e tyre të internetit ose në ambiente biznesi të hapura për publikun.



Publikimi i shpalljes është i detyrueshëm vetëm për punëdhënësit e sektorit publik ose për ndërmarrjet shtetërore.

Aplikimi për vend pune

Aplikoni për shpallje pune me letër motivimi dhe rezyme. Përshtateni përmbajtjen me pritshmëritë e punëdhënësit dhe kushtet e punës.

Formulari më i zakonshëm për rezyme pune është pamja tabelare, për shembull EUROPAS .

Njohja e arsimimit dhe kualifikimeve

Arsimi i fituar në Maqedoni njihet edhe në Sllloveni.

Megjithatë, për shkak të sistemeve të ndryshme arsimore, ju duhet të filloni procesin e vlerësimit të arsimimit tuaj. Filloni në organin Eric Naric.

Leje pune

Nëse keni ndërmend të punoni dhe të gjeni punë në Sllloveni, duhet të merrni leje qëndrimi dhe vend pune për të hyrë në vend, për të jetuar dhe punuar në të, ose për të marrë statusin e punonjësit.

Edhe ju edhe punëdhënësi juaj mund të aplikoni për leje. Të dy mund të aplikojnë për zgjatjen e lejes. Ju aplikoni për lejen e parë jashtë vendit dhe punëdhënësi juaj mund të aplikojë në Sllloveni. Në rrethana të veçanta, ju mund të aplikoni për lejen e parë në Sllloveni.

Formularët e aplikimit janë në dispozicion në anglisht, shqip, boshnjakisht, maqedonisht dhe serbisht.

Kontrata e punës

Ligji për Marrëdhëniet e Punës përcakton pjesët ose informacionet e detyrueshme të kontratës së punës që duhet të përfshihen me shkrim.

Karakteristikat e kontratës së punës sllovene janë :

- Certifikatë mjekësore e detyrueshme para punësimit ,
- Provimi i detyrueshëm i shëndetit dhe sigurisë në punë para punësimit,
- Kompensim i detyrueshëm për ushqim dhe transport për në punë,
- Së paku 4 javë pushim vjetor,
- Orari i plotë i punës është 40 orë në javë.

Pas punësimit, punëdhënësi juaj ju regjistron për sigurim shëndetësor dhe pensional.

Shpenzimet e akomodimit dhe të jetesës

Qiraja për një apartament në studio në Lubjanë është afërsisht 400 to 500 euro, kurse për apartament me dy dhoma, qiraja kushton nga 700 deri ne 800 euro . Marrja me qira e një apartamenti në pjesën më të madhe të Sllovenisë është për rreth 20% më e ulët se në Ljubljanë.





Sipas Entit të Statistikave, çmimet e kostos janë si më poshtë:

- Çmimi mesatar i një filxhani kafeje të zezë ose ekspres është 1.48 EUR,
- Çmimi mesatar i drekës në restorant (për meny) kushton 11.76 EUR,
- Një kilogram mollë kushton 1.51 euro,
- Një kilogram mish viçi pa kocka kushton 9.59 euro,
- Një kilogram djathë kushton 11.12 euro,
- Një biletë kinemaje kushton 6.09 EUR,
- Një biletë mesatare bazë për transportin publik kushton 1.10 euro,
- Një litër benzinë motorik 95 kushton 1421 euro.